


PLANI I GRUPIT TË PARË



Kopshti: “ _____ ”

PLANIFIKIMI TEMATIK MËSIMOR VJETOR

GRUPI I PARË - Mosha 3 – 4 vjeç

VITI SHKOLLOR 2024 -2025

Punoi:

Pranoi:

Mësuese e grupit të parë

Drejtuese e institucionit

Sqarim:

1. Sipas “Rregullores së Institucioneve Arsimore Parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, Kreu II, Neni 5 “Organizimi i institucioneve të arsimit parashkollor”, pika 1, thuhet: *“Kopshtet e zhvillojnë aktivitetin e tyre gjatë gjithë vitit kalendarik për fëmijët 3-6 vjeç, për çdo grup (me ose pa ushqim).* Për këtë arsye kopshtet kanë më shumë se sa 35 javë mësimore, aq sa janë parashikuar në Strukturën e Vitit Shkollor 2024-2025, të miratuar me Urdhrin e përbashkët, me nr 193, datë 30.04.2024.

2.Tremujori i parë, për periudhën shtator-dhjetor 2024, sipas udhëzimit mësimi duhet të zhvillohet gjatë 14 javëve mësimore. Por kopshti nuk e ka pushim periudhën 23 – 31 dhjetor 2024, prandaj plani i tremujorit të parë është me 17 javë mësimore. Mësimin mund ta zhvilloni gjatë 14 javëve mësimore, ndërsa 3 javët e tjera do t’ju shërbejnë për të përforcuar konceptet e mësuara gjatë kësaj periudhe; mund të shfrytëzohen si orë për projekte apo miniprojekte, si dhe për aktivitete të tjera me fëmijët dhe prindërit e tyre.

3.Tremujori i dytë, për periudhën janar-mars 2025, mësimi do të zhvillohet gjatë 12 javëve mësimore. 23 – 31 dhjetor 2024. Kjo përputhet edhe me parashikimin e udhëzimit nr 193.

4Tremujori i tretë, për periudhën prill-qershor 2025, sipas udhëzimit mësimi duhet të zhvillohet gjatë 9 javëve mësimore. Por kopshti nuk e ka pushim periudhën 31 mars – 4 prill 2025, prandaj plani i tremujorit të tretë është me 12 javë mësimore. Mësimin mund ta zhvilloni gjatë 9 javëve mësimore, ndërsa 3 javët e tjera do t’ju shërbejnë për të përforcuar konceptet e mësuara gjatë kësaj periudhe; mund të shfrytëzohen si orë për projekte apo miniprojekte, si dhe për aktivitete të tjera me fëmijët dhe prindërit e tyre, për festën e 1 Qershorit.

PLANI MËSIMOR VJETOR-GRUPI I PARË

Muaji	Javët mësimore	Datat	Tematikat mujore	Temat javore
Shtator	1	09–13 shtator 2024	Sa i bukur kopshti im	Kopshti im
	2	16–20 shtator 2024		Shokët/shoqet dhe mësuesja ime
	3	23–27 shtator 2024		Në kopsht luajmë dhe mësojmë
Tetor	4	30 – 4 tetor 2024	Në kopësht vij me dëshirë	Sa i bukur kopshti im
	5	7 – 11 tetor 2024	Vjeshtë e artë	Ngjyrat e vjeshtës
	6	14 – 18 tetor 2024		Vjeshta është bujare
	7	21 – 25 tetor 2024		Cili jam unë?!
	8	28–31 (1) tetor 2024		Trupi im
Nëntor	9	4– 8 nëntor 2024	Kujdesi për shëndetin	Kujdesi për shëndetin tim
	10	11 – 15 nëntor 2024	Festat e Nëntorit	Unë kam të drejtë...
	11	18–21 nëntor 2024		Dita e Alfabetit
	12	25–27 nëntor 2024		Festat e Nëntorit
Dhjetor	13	2 - 6 dhjetor 2024	Toka dhe festat	Dita dhe nata
	14	10–13 dhjetor 2024		Po afrohen festat
	15	16–20 dhjetor 2024		Përgatitja për festë
	16	23–27 dhjetor 2024		Festojmë së bashku
	17	30-31 dhjetor 2024		Traditat e festës së Vitit të Ri
Janar	18	6-10 janar 2025	Trokiti dimri	Kur troket dimri
	19	13-17 janar 2025		Kafshët në dimër
	20	20-24 janar 2025		Veshjet në dimër
	21	27-31 janar 2025		Kam mësuar gjëra shumë në kopshtin

				tim
Shkurt	22	3-7 shkurt 2025	Familja dhe mirësjellja	Banesa ime
	23	10-14 shkurt 2025		Unë kam një familje
	24	17-21 shkurt 2025		Mirësjellja
	25	24-28 shkurt 2025		Çfarë më pëlqen mua?
Mars	26	3-7 mars 2025	Çelin lulet	E dua mamin dhe mësueset
	27	10-13 mars 2025		Sa shumë lule kanë çelur
	28	17-21 mars 2025		Natyra u gjallërua
	29	25-28 mars 2025		Pemët në pranverë
Prill	30	1 – 4 prill 2025	Fshati dhe qyteti	Ushqehemi shëndetshëm
	31	7 – 11 prill 2025	Balonat	Në qytet apo në fshat
	32	14 – 18 prill 2025		Produktet që marrim nga fshati
	33	23 – 25 prill 2025		Përgatisim dhe ngremë balonat
	34	28 – 2 maj 2025		Dua të bëhem si mami, babi im
Maj	35	5 – 9 maj 2025	Bota e kafshëve	Kafshët e egra
	36	12 – 16 maj 2025		Shpendët
	37	19 – 23 maj 2025		Bota nënujore
	38	26 – 30 maj 2025		Përgatitemi për festën tonë – 1 Qershorin
Qershor	40	2 – 6 qershor 2025	Pushimet verore po afrohen	Jam krenar për ato që kam mësuar
	41	10 –13 qershor 2025		Përgatitja për pushimet verore

Rezultatet vjetore të të nxënit sipas kompetencave lëndore

Lëndët	Rezultatet e të nxënit sipas lëndëve
Gjuhë shqipe	<p>Dëgjon më vëmendje bashkëmoshatarët dhe të rriturit.</p> <p>Shfaq interes për informacione të ndryshme nga bashkëmoshatarët dhe të rriturit.</p> <p>Zbaton udhëzimet ose porositë që kërkojnë realizimin e veprimeve me dy deri në tri komanda.</p> <p>Zbaton rregullat e të dëgjuarit në grup.</p> <p>Kupton udhëzime të thjeshta.</p> <p>Kupton prezantime gojore të moshatarëve dhe të të rriturve rreth temave të përshtatshme për moshën e tij.</p> <p>U përgjigjet pyetjeve të thjeshta</p> <p>Tregon një ngjarje.</p> <p>Shpreh me gjuhë të thjeshtë përjetimet dhe emocionet që e kanë shoqëruar gjatë dëgjimit të një teksti (përrallë, tregim, histori, poezi etj.).</p> <p>Shpreh me fjali të thjeshta pëlqimet e tij rreth ngjarjeve dhe personazheve të tekstit.</p> <p>Kupton tekste të thjeshta joletrare e letrare.</p> <p>Identifikon format e thjeshta letrare: përrallëza, përralla, tregime të shkurtra, vjersha, poezi, etj.</p> <p>Dallon tinguj të ndryshëm në fjalë dhe fjalët në një fjali.</p> <p>Pasuron fjalorin me fjalë të reja, me shprehje të veçanta gjuhësore dhe me fjali nga fusha të ndryshme të jetës.</p> <p>Shfaq interes ndaj të tjerëve gjatë bashkëbisedimeve.</p> <p>Merr pjesë në bashkëbisedime.</p> <p>Respekton mendimin e të tjerëve.</p> <p>Dëshmon vullnet dhe gatishmëri në detyra individuale dhe në grupe.</p> <p>Përdor imagjinatën dhe shpirtin krijues për zgjidhjen e problemeve të ndryshme.</p> <p>Tregon kureshtje dhe vetëbesim gjatë realizimit të detyrave të ndryshme.</p> <p>Flet në mënyrë të kuptueshme dhe me intonacionin e duhur, kur tregon një ngjarje, një përvojë të tijën ose kur përshkruan diçka, etj.</p> <p>Bën pyetje dhe jep përgjigje të thjeshta.</p> <p>Përdor fjali gjithnjë e më të plota.</p> <p>Ndan me të tjerët përvojat, mbresat dhe emocionet e tij.</p> <p>Njeh fjalët e disa poezive ose këngëve.</p> <p>Reciton përmendësh vjersha të shkurtra.</p>

Përcjell një mesazh të thjeshtë me fjalët e veta.
Flet dhe diskuton për tema të ndryshme.
Merr pjesë në lojë me role.
Kujton dhe përsërit fjali dhe shprehje të plota nga të tjerët.
Përdor gjeste jo verbale, të tilla si shprehje a gjeste të fytyrës gjatë të folurit.
Tregon e ritregon ngjarjet duke i shoqëruar me gjeste.
Kënaqet duke përsëritur ngjarjet, poezitë dhe këngët.
Prezanton veten para të tjerëve.
Mban radhën në biseda dhe respekton të tjerët.
Diskuton në mënyrë aktive për atë që ka dëgjuar.
Diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë dhe respekton rregullat e komunikimit në grup.
Pyet, përgjigjet, shpreh mendimet, ndjenjat dhe emocionet e tij.
Shfaq vëmendje ndaj të tjerëve gjatë bashkëbisedimeve.
Dëshmon vullnet dhe gatishmëri në detyra individuale dhe në grupe.
Përdor imagjinatën dhe shpirtin krijues për zgjidhjen e problemeve të ndryshme.
Bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme.
Kritikon duke u mbështetur mbi argumente.
Tregon kureshtje dhe vetëbesim gjatë realizimit të detyrave të ndryshme.
Mban trupin në një qëndrim të përshtatshëm dhe librin në pozicionin e duhur gjatë kohës që e shfleton atë.
Bën sikur lexon duke lëvizur buzët.
Njeh dhe dallon pjesën me foto ose ilustrime dhe pjesën e shkruar në një tekst.
Jep përgjigje të thjeshta rreth tekstit.
Dallon shkronjat e shtypit dhe tingujt e gjuhës shqipe.
Kupton tekstet që janë të shoqëruara me shumë ilustrime dhe me pak fjalë.
Flet rreth pikturave dhe ilustrimeve në tekst.
Fillon të vëzhgojë faqet nga lart-poshtë dhe nga e majta në të djathtë.
Kupton kur një tekst është për t'u "lexuar".
Përdor figurat për të shprehur kuptimet e tyre dhe shfaq emocionet e tij.
Dallon shkronjat e shtypit.
Identifikon disa shkronja.
Flet dhe shfaq emocione në varësi të tekstit.
Imiton zërin e një personazhi.

	<p>Tregon pse i pëlqen një personazh në një tekst. Tregon interes dhe dëshirë për të lexuar. Shfaq besim dhe vullnet për të lexuar. Ndan me të tjerët përvojat e tij rreth leximit. Pranon dhe tregon respekt ndaj ideve të të tjerëve për tekstet që lexojnë. Eksperimenton me mjetet dhe materialet e të shkruarit (laps, letër, ngjyra, shkumës etj.). Përdor shkarravina, vizatime dhe letra për të shkruar. U shpjegon të tjerëve se çfarë ka synuar të tregojë me vizatimet dhe “shkrimet” e tij. Kopjon ose shkruan. Bashkon pikat për të formuar shkronjat kapitale. Përdor simbole ose vizatime për të përfaqësuar gjuhën e folur. Kopjon disa prej shenjave të mjedisit ose simbole. Dallon se disa shkronja janë të mëdha e disa të vogla (shkronjat e shtypit). Njih disa nga shkronjat e shtypit. Përdor shkarravina për të shkruar lista, shkronja dhe histori. Kërkon nga të rriturit që ta përshkruajnë me shkrim vizatimin e tij. Bën sikur shkruan shënime, duke përdorur shkronja të sajuara. Shpreh me vizatim dhe me fjali të shkurtra një ngjarje apo histori. Shfaq besim dhe vullnet gjatë procesit të të shkruarit. Kënaqet me komentet e të rriturve për punimet e veta artistike.</p>
<p>Matematikë</p>	<p>Njih numrat natyrorë deri në 10. Shkruan numra natyrorë deri në 3. Numëron deri në 10. Rendit disa numra deri në 10 (në rendin rritës ose zbritës). Mbledh deri në 10 duke përdorur shtimin ose bashkimin e dy grupe sendesh. Zbret deri në 10 duke përdorur pakësimin ose plotësimin (p.sh: 5 mollë heqim 2 mollë, mbeten 3 mollë). Identifikon termat “shumë” dhe “ndryshesë”. Zgjidh problema me situata të njohura për të. Paraqet dhe komunikon lirshëm mendimet e tij. Shfaq interes për numrat dhe numërimin.</p>

Përdor imagjnatën për zgjidhjen e problemeve të thjeshta me numra.
Demonstron pavarësi në mendime dhe veprime.
Demonstron besim në forcat e veta.
Respekton përpjekjet personale dhe ato në grup.
Mat gjatësinë e sendeve duke përdorur gjatësi jostandarde matjeje.
Vlerëson me sy gjatësinë e sendeve dhe i krahason ato duke i vendosur mbi njëra-tjetrën.
Përdor njësitë jostandarde të matjes (“më i gjatë”, “po aq i gjatë”, “më i shkurtër”).
Rendit nga më i gjati te më i shkurtri ose anasjelltas, të paktën 4 sende.
Përdor njësine e përshtatshme të kohës (1 ditë, 1 javë, 1 muaj, 1 vit) për përcaktimin kohor të një veprimtarie ose ngjarjeje.
Përdor shprehjet: mëngjes, drekë, mbrëmje; paradite, pasdite; ditë, natë, “dje”, “sot”, “nesër”.
Parashikon, në njësine e përshtatshme të kohës, kohëzgjatjen e ngjarjeve që kanë lidhje me situata nga jeta e përditshme (p.sh., kohëzgjatja e pushimeve verore matet me ditë ose muaj, etj.).
Përdor (me anë të veprimtarive konkrete dhe ilustrimeve) njësitë jostandarde për peshimin e sendeve përkatëse (“më i rëndë”, “më i lehtë”, “po aq i rëndë”).
Përdor monedhat nga 10 deri në 100-lekëshe.
Zgjidh problema nga situata me blerje të njohura për ta.
Është inovativ dhe paraqet idetë e reja të tij.
Demonstron kuriozitet për matjen e gjatësive, masave, kohës, si dhe për monedhat.
Organizon lidhjen konceptuale të njohurive.
Përdor imagjnatën për zgjidhjen e problemeve me njësitë.
Vetëvlerësohet në situata të thjeshta.
Dallon dhe emërton format 2D (katror, trekëndësh, rreth, drejtkëndësh, rreth).
Vizaton me dorë të lirë katrorin, trekëndëshin, drejtkëndëshin.
Dallon dhe emërton në mjedise objekte në formë kubi, sferë, etj.
Përkrah vendndodhjen e një objekti duke përdorur fjalë të orientimit në hapësirë, si: para, pas, lart, poshtë, përballë, majtas, etj.
Lëviz në drejtime të caktuara duke u orientuar nga fjalët (para; drejt; prapa derës; afër karriges; nën tavolinë; etj).
Paraqet dhe komunikon lirshëm mendimet e tij.
Shfaq kërshëri për figurat 2D.
Përdor imagjnatën për kombinimin e figurave.
Tregon pavarësi në mendime dhe veprime.

	Dallon dhe vazhdon një varg sipas një rregulli (me një ose dy kritere).
Dituri natyre	<p>Dallon bimët nga qeniet e tjera të gjalla që i vëzhgon në mjedisin rrethues ose i shikon në fotografi.</p> <p>Bën pyetje të thjeshta për bimët dhe kafshët që vëzhgon duke përdorur shqisat.</p> <p>Përdor mjetet e duhura për të mbledhur informacion dhe për të vëzhguar gjallesat.</p> <p>Zhvillon fjalorin dhe përdor komunikimin gjuhësor kur identifikon një bimë ose pjesë të saj.</p> <p>Identifikon kafshë të ndryshme të njohura në mjediset rrethuese ose në fotografi.</p> <p>Identifikon dhe përshkruan shqisat e njeriut.</p> <p>Nëpërmjet shembujve konkretë demonstroi përdorimin e secilës shqisë.</p> <p>Tregon ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet grupeve të ndryshme të gjallesave dhe brenda të njëjtit grup.</p> <p>Ndan bimët dhe kafshët në varësi të mjedisit ku jetojnë dhe në bazë të karakteristikave të jashtme të dallueshme.</p> <p>Shfaq kuriozitet për botën e gjallesave.</p> <p>Tregon interes për të mësuar më tepër në lidhje me kafshët e buta, kafshët e egra, shpendët dhe insektet.</p> <p>Shprehet në rastet kur sheh se po dëmtohet një kafshë a një bimë.</p> <p>Shfaq kënaqësi në lidhje me shumëllojshmërinë dhe bukurinë e botës së kafshëve dhe të bimëve.</p> <p>Përshkruan pjesë të caktuara të trupit të kafshëve që ka vëzhguar.</p> <p>Vëzhgon dhe dallon larminë e peizazhit natyror në mjedisin e afërt.</p> <p>Vëzhgon dhe identifikon mjediset e ndërtuara nga njeriu.</p> <p>Nëpërmjet vizatimeve shfaq pjesë nga mjedisi që ka vëzhguar.</p> <p>Bën pyetje rreth elementeve të mjedisit (tokës, ujit, ajrit, zjarrit).</p> <p>Përshkruan me gojë itinerarin që ndjek nga shtëpia në kopsht (shkollë), nga shtëpia e vet te gjyshërit, etj.</p> <p>Zgjeron njohuritë për mjedisin dhe tregon kujdes në rritje ndaj tij.</p> <p>Shfaq kuriozitet për të njohur mjedisin që e rrethon.</p> <p>Vlerëson bukuritë natyrore dhe peizazhet e bukura të ndërtuara nga dora e njeriut.</p> <p>Shfaq dëshira personale që lidhen me përmirësimin e mjedisit ku jeton.</p> <p>Tregon veti të lëndëve (ngjyra, cilësia, madhësia, forma).</p> <p>Përdor vëzhgimet individuale kur pyetet për të përshkruar karakteristikat e lëndëve dhe të objekteve të vëzhguara.</p> <p>Vendos materialet dhe objektet sipas një rendi ose në grupe sipas një ose më shumë cilësive që kanë.</p> <p>Përshkruan disa veti të materialeve dhe të objekteve përreth.</p> <p>Shfaq kuriozitet për kryerjen e eksperimenteve.</p> <p>Shfaq interes për të marrë pjesë në përgatitjen e gatimeve të thjeshta.</p> <p>Tregon mënyra se si mund ta kursejë ujin në familje.</p>

	<p>Zbulon vazhdimësi dhe ndryshime kur vëzhgon procese të rritjes dhe përdor komunikimin gjuhësor për t'i përshkruar këto ndryshime.</p> <p>Vëren se bimët rriten, lulëzojnë dhe ndryshojnë pamjen e tyre.</p> <p>Bën pyetje kur vëzhgon dhe përshkruan ciklin jetësor të një organizmi që pëson ndryshime shumë të mëdha.</p> <p>Shfaq kuriozitet për ciklet jetësore të gjallesave.</p> <p>Tregon dashuri dhe kujdes për të vegjlit e kafshëve të buta dhe atyre shtëpiake.</p> <p>Tregon kujdes për bimët e sapo mbjella.</p> <p>Kryen vëzhgime për motin duke përdorur një shqisë ose kombinime të disave prej tyre.</p> <p>Përshkruan karakteristikat e motit, bazuar në vëzhgimet individuale.</p> <p>Vëren vijueshmëri dhe modele në dukuritë e motit dhe përdor komunikimin gjuhësor për t'i përshkruar këto ngjarje duke përfshirë terma, si: mot me erë / me mjegull/ me diell/ ngrohtë / nxehtë / ftohtë, etj.</p> <p>Emërton dhe dallon stinët e vitit, etj.</p> <p>Përshkruan disa veti të stinës lidhur me karakteristikat e motit dhe veshjet që përdorim.</p> <p>Shfaq interes për plotësimin e kalendarit të motit për çdo ditë.</p> <p>Shfaq kuriozitet për të mësuar rreth karakteristikave të stinëve dhe motin në secilën prej tyre.</p> <p>Dallon ditën dhe natën në vizatime/ fotografi etj.</p> <p>Bën përshkrime të shkurtra për të treguar veprimtari që kanë ndodhur gjatë ditës ose natës.</p> <p>Shfaq interes për të regjistruar se çfarë bën gjatë ditës.</p> <p>Shfaq kuriozitet për të vëzhguar qiellin natën.</p>
<p>Edukim për shoqërinë</p>	<p>Identifikon dhe përshkruan karakteristika të vetes së tij/saj.</p> <p>Identifikon dhe përshkruan emocionet që përjeton (p.sh., gëzim, frikë, mërzitje, etj.).</p> <p>Tregon për gjëra që i pëlqejnë.</p> <p>Tregon për nevojat e tij/saj.</p> <p>Identifikon dhe përshkruan karakteristika të pjesëtarëve të familjes dhe të shokëve /shoqeve.</p> <p>Diskuton (bashkëbisedon) mbi ngjashmëritë dhe dallimet (p.sh., sytë, flokët, lartësia, talentet, gjinia, interesat, parapëlqimet për ushqimin, etj).</p> <p>Sugjeron ide ose veprime për t'i përshtatur ndryshimeve përgjatë lojës ose në aktivitetet në grup.</p> <p>Identifikon dhe ndjek rregulla dhe rutina në klasë (p.sh., vendos sendet personale në vendin e përcaktuar, larja e duarve, pastrimi, etj.).</p> <p>Kujdeset për pajisjet në kopsht dhe në mjedise të tjera publike (p.sh., pajisjet në klasë, bimët në park, etj).</p> <p>Shpreh mendimet, ndjenjat dhe dëshirat e tij.</p>

Beson te vetja dhe tek të tjerët.
Respekton përpjekjet personale dhe ato në grup.
Respekton vetveten.
Tregon interes për nevojat e të tjerëve.
Ndan gjërat me shokët e klasës.
Respekton idetë dhe përvojat e të tjerëve.
Bashkëvepron me të tjerët, me bindjen se kjo është e nevojshme.
Tregon gatishmëri për të ndihmuar shokët, të moshuarit, etj.
Identifikon ngjashmëritë dhe ndryshimet me të tjerët (shokë/shoqe, pjesëtarë të familjes, anëtarë të tjerë të komunitetit).
Përshkruan tipare të përbashkëta dhe të veçanta që kanë familjet. Përshkruan detyrat dhe përgjegjësitë që kanë anëtarët e familjes.
Tregon për festat dhe traditat në familje (p.sh., ditëlindje, festa, etj).
Identifikon simbole të vendit tonë (p.sh., flamuri).
Kupton se pavarësisht ndryshimeve, të gjithë janë të barabartë.
Vlerëson sjelljet qytetare në interes të së mirës së përbashkët.
Merr pjesë me dëshirë në ceremoni festive.
Shfaq respekt për veten dhe për të tjerët.
Gëzohet kur merr pjesë në festa, ditë e data të shënuara.
Identifikon ndryshimet që i kanë ndodhur gjatë rritjes.
Përshkruan pse njerëzit ndryshojnë me kalimin e kohës.
Përshkruan sesi ndryshon familja me kalimin e kohës.
Identifikon ngjarje sipas rendit kohor.
Shpreh ndjenja dhe emocione pozitive për të kaluarën e vet.
Shpreh pëlqim ose mospëlqim sipas situatës apo kontekstit në të cilin ndodhet.
Mban qëndrimin e duhur në situata të vështira.
Vlerëson përparimin e teknologjisë, shkencës dhe shoqërisë, duke u nisur nga jeta e përditshme.
Justifikon veprime/ gabime që ka bërë kur ka qenë më i vogël.
Identifikon kopshtin dhe qytetin ku jeton.
Eksploron (vëzhgon) tipare të mjediseve të afërta (p.sh., mjedisit të lagjes ku jeton) dhe të largëta (p.sh., një vend ku ka kaluar pushimet).
Përshkruan mjedisin (komunitetin) ku jeton dhe aktivitetet që mund të kryhen aty.

Përshkruan aktivitetet që kryen përgjatë pushimeve. Identifikon të përbashkëtat dhe të veçantat midis aktiviteteve që mund të kryejë në shtëpi dhe përgjatë pushimeve.

Identifikon çfarë e bën një vend të veçantë (p.sh., një park, një lumë, etj.).

Përshkruan si njerëzit mund të kujdesen për vende të ndryshme.

Identifikon tokën dhe ujin në hartë dhe glob.

Diskuton mbi rëndësinë e kujdesit për ajrin, tokën dhe ujin. Identifikon dhe përshkruan disa nga të drejtat e fëmijëve.

Identifikon shembuj të përgjegjësi.

Identifikon dhe përshkruan rregullat në familje dhe në kopsht.

Përshkruan nevojën e vendosjes dhe zbatimit të rregullave.

Tregon për pasojat e shkeljes së rregullave.

Gjen mënyrën e duhur për të zgjidhur një situatë konfliktuale.

Tregohet i gatshëm për të zbatuar rregullat e vendosura.

Ndien përgjegjësi për hartimin e rregullores së klasës.

Dënon rastet e shkeljes së rregullave, si dhe personat përgjegjës.

Merr pjesë aktive në ngjarje të rëndësishme për bashkëmoshatarët e tij.

Vlerëson figurat e shquara historike.

Bën dallimin ndërmjet nevojave dhe dëshirave.

Flet për rëndësinë që kanë për të ushqimi, veshja, banesa, familja, lojërat, dashuria dhe respekti, librat, siguria, etj.

Përshkruan punët që bëjnë njerëzit e familjes për të siguruar paratë.

Tregon sesi familjet i përdorin paratë për të plotësuar nevojat dhe dëshirat e tyre.

Dallon disa nga shërbimet për të cilat njerëzit kanë nevojë në lagjen ku banojnë.

Dallon disa nga institucionet që mund të ofrojnë shërbime për komunitetin ku jeton (për shembull, tregon se çfarë shërbimesh mund të ofrojnë: ambulanca, policia, zjarrfikësja, etj.).

Tregon se çfarë mund dhe duhet të bëjnë fëmijët dhe banorët e tjerë të komunitetit për të rritur cilësinë e shërbimeve dhe që të përfitojnë prej tyre.

Respekton profesionet dhe shërbimet e ndryshme që kryhen në shoqëri.

Shfaq respekt për njerëzit që punojnë.

Vlerëson përpjekjet që bëjnë prindërit për të plotësuar nevojat dhe dëshirat e fëmijëve.

Tregon me raste konkrete pse nevojat e familjes janë mbi dëshirat personale të fëmijëve.

Pranon rëndësinë e pjesëmarrjes së tij në komunitet.

**Edukimi
fizik,
sportet dhe
shëndeti**

Përfshihet në lojërat që zhvillohen në grup, duke respektuar rregullat e tyre.
Tregohet i vëmendshëm gjatë zhvillimit të lojës.
Bashkëvepron gjatë lojërave në grup dhe tregon shenjat e para të sjelljes sportive.
Kryen skema të thjeshta lëvizore.
Ngjit dhe zbret shkallët duke alternuar këmbët.
Kordinon pjesët e trupit sipas lëvizjeve që bën.
Ecën dhe vrapon rreth pengesave dhe objekteve.
Kërcen me dy këmbë mbi objekte të vogla dhe ruan ekuilibrin.
Kapërcen pengesa, zvarritet, ecën në një tra të ulët ekuilibri, ngjit dhe zbret shkallët i sigurt dhe me vrap, duke alternuar këmbët (një këmbë për një shkallë).
Bën kapërdimje për t'u hedhur e për t'u rrotulluar.
Pozicionon trupin në përshtatje me veprimet që kryen.
Kryen kërcime individuale me litar.
Kryen veprimin lëvizor të goditjes në shenjë.
Di t'i përmbajë emocionet vetjake si në rastin e fitores, edhe në rastin e humbjes së lojës/garës.
Merr pjesë aktive në lojë.
Zbaton rregullat e thjeshtuara të lojës.
Ruan qetësinë gjatë lojës.
Bashkëpunon gjatë lojës me shokët e skuadrës.
Zbaton teknikat fillestare të elementeve të pasimit të topit me dy duar dhe me këmbë.
Qëndron në pozicionin e duhur gjatë lojës.
Respekton kundërshtarët në lojë.
I afrohet objektit gjatë gjuajtjes në shenjë.
Kujdeset për higjienën personale: lan duart, fytyrën, qafën dhe veshët.
Mban trupin drejt për një shëndet të mirë të shtyllës kurrizore.
Përshtat veshjen me lojën/ veprimtarinë sportive që kryen.
Kryen praktikat higjieno-sanitare gjatë ngrënies, fjetjes dhe lojës.
Zbaton rregullat e sigurisë për jetën në klasë, në familje dhe në rrugë.
Kërkon të dezinfektojë plagën e shkaktuar gjatë lojës.
Ha produkte të shëndetshme ushqimore.
Tregon simptoma të thjeshta që shfaqen nga sëmundje të moshës, si: temperaturën, kollën, dhimbjen e barkut, të veshit, të kokës, të dhëmbit, etj.
Reagon kur ndihet i lodhur dhe kërkon të pushojë.

Artet	Muzikë
	<p>Dallon tinguj që prodhohen në natyrë.</p> <p>Dallon tinguj që ndeshen në mjedisin rrethues.</p> <p>Imiton tingujt, zhurmat, zërat e ndryshëm që dëgjon në mjedisin përreth.</p> <p>Imiton goditjet ritmike që dallon në natyrë dhe në mjedisin rrethues.</p> <p>Krijon modele ritmike duke përdorur mjetet trupore, si shuplakat dhe këmbët apo dhe objekte të ndryshme me goditje.</p> <p>Nxjerr tinguj të ndryshëm duke luajtur me zërin.</p> <p>Dallon tingujt që lëshojnë të paktën 2-3 instrumente muzikore.</p> <p>Jep disa karakteristika të tingujve (vokalë apo të instrumenteve) që dëgjon.</p> <p>Këndon solo dhe në grup.</p> <p>Këndon këngë të thjeshta dhe të njohura, sipas grupmoshave.</p> <p>Zbaton rregullat të kënduarit: hapja e gojës, frymëmarrja, intonimi, qëndrimi, shqiptimi.</p> <p>Këndon dhe shoqëron me lëvizje trupore melodinë gjatë të kënduarit.</p> <p>Realizon lojën muzikore apo ritualin popullor sipas koreografisë së caktuar nga mësuesja.</p> <p>Shoqëron këngët, lojërat muzikore apo ritualet popullore a) me lëvizje, b) me mjete trupore ose c) me instrumente me goditje.</p> <p>Improvizon me ritmin (me dy dhe me katër goditje).</p> <p>Imiton me zërin e vet tinguj të ndryshëm që dëgjon, duke iu përafëruar origjinalit.</p> <p>Imiton karakteristikat e tingujve që dëgjon.</p> <p>Shpjegon tingujt dhe ritmet që dëgjon.</p> <p>Përdor/ sajton instrumente të thjeshta muzikore.</p> <p>Prodhon ritme dhe tinguj me mjete rrethore ose instrumente të ndërtuara nga vetë fëmijët.</p> <p>Zbulon tinguj, zhurma, goditje në mjedisin përreth dhe thotë sesi ndihet.</p> <p>Dallon nëse ritmi i muzikës është i shpejtë ose i ngadaltë.</p> <p>Imiton tingujt, zhurmat, zërat e ndryshëm, goditjet e ndryshme ritmike që dëgjon në mjedisin përreth.</p> <p>Komenton me fjalë të thjeshta këngët që dëgjon.</p> <p>Shpreh emocionet për këngët dhe lojërat muzikore që këndon apo dëgjon.</p> <p>Përdor simbole të ndryshme grafike për të shprehur gjendje të ndryshme emocionale nga muzika e dëgjuar.</p> <p>Shfaq interes për një numër të caktuar këngësh, vallesh dhe pjesësh muzikore.</p> <p>Tregon emrin e këngëtarëve që pëlqen.</p>

Lëviz nën ritmin e muzikës që luhet në çaste të qeta.
Tregon si ndihet kur dëgjon pjesë të ndryshme muzikore.
Shoqëron me lëvizje trupi këngën që këndon ose dëgjon.

Artet pamore

Vizaton llojet e vijave: të shkurtra, horizontale dhe vertikale.
Dallon figura të thjeshta gjeometrike.
Dallon tri ngjyrat bazë (e kuqe, e verdhë, blu).
Bëhet i ndjeshëm ndaj ngjyrave në mjedisin që e rrethon.
Vizaton llojet e vijave: të shkurtra, horizontale, të gjata, të valëzuara.
Përcakton forma dhe figura të thjeshta gjeometrike (rrethi dhe sfera, katrori dhe kubi, trekëndëshi dhe piramida).
Bëhet i vetëdijshëm për natyrën tridimensionale të formës në objekte (vëllimi në një lodër, te një kafshë, te një top, në një kuti, etj).
Identifikon ngjyrat bazë në mjedisin që e rrethon.
Dallon karakteristika të teksturës së materialeve (p.sh. druri i fortë, tekstilet e buta, tavolinë e lëmuar, muri i ashpër).
Dallon vijën e hollë/ e trashë në natyrë dhe mjedisin përreth.
Vizaton figura dhe objekte të njohura për të, nëpërmjet vijës, duke përdorur mjete të ndryshme: laps, shkumës, stilolaps, pastel, lapustil.
Dallon format natyrore dhe gjeometrike në natyrë dhe mjedisin që e rrethon.
Përdor format gjeometrike dhe natyrore në krijimin e vet.
Ndërton forma tridimensionale me plastelinë, letër, karton dhe konstruksione.
Dallon ngjyrat në natyrë dhe në mjedisin që e rrethon.
Përdor ngjyrat në krijim me lapsa me ngjyra, penela dhe tempera.
Përdor materiale me tekstura të ndryshme: letra, karton, pëlhurë, etj.
Vizaton motive të ndryshme në krijim: retë në qiell, vijëzime, etj.
Përsërit dhe krahason motivin në një stampim.
Eksperimenton me mjete dhe materiale të ndryshme të vizatimit, pikturës, skulpturës, konstruksioneve.
I përdor mjetet e vizatimit e të pikturës mbi letra A3 ose A2 me sipërfaqe të ndryshme.
Vizaton dhe ngjyros duke u mbështetur në përvojat personale, në jetën e përditshme dhe në historitë e dëgjuara/të lexuara, që kanë lidhje me shtëpinë, lodrat, ëndrrat, dëshirat, personazhet, festat, rastet e veçanta, etj.
Eksperimenton me stampa të thjeshta, si sfungjeri, fruta e perime të ndryshme, pëllëmbën e dorës, shputën e këmbës, etj.
Përdor një ose dy ngjyra për t'u fokusuar tek tekstura, forma dhe motive të ndryshme.

Shfrytëzon mundësitë e modelimit me plastelinë (shtyp, tërheq, ndan, shpon e copëton plastelinën në copa dhe e bashkon përsëri; fillon të bëjë dallimin midis formave të sheshta dhe atyre solide që qëndrojnë më këmbë).
Krijon forma të thjeshta me plastelinë.
Eksperimenton me materialet që përdoren për konstruksione (grupon, ndërton me pjesë të vogla dhe lodra konstruksioni).
Identifikon objekte apo personazhe të njohura nga fotografitë, ilustrimet apo nga vepra arti.
Tregon materialet që ka përdorur në punim.
Vendos titullin e punimit dhe e shpjegon atë.
Komenton me një fjalor të thjeshtë punën e vet dhe të të tjerëve.
Vëzhgon me kuriozitet veprat e artit dhe objekte të ndryshme artizanati.
Përshkruan atë që sheh në një vepër arti, në një objekt të njohur artizanati dhe fotografi.
Identifikon ngjyra dhe forma që janë përdorur në një vepër arti.
Tregon pjesën që pëlqen më shumë.
Zbulon disa profesione që lidhen me artin (artist, artizan, piktor, skulptor).
Viziton një ekspozitë në muze, në galeri arti ose qendër kulturore dhe shpreh mbresa rreth saj.
Merr pjesë në ekspozimin e punimeve në klasë.

TREMUJORI I PARË-SHTATOR-DHJETOR 2024

Muaji	Javët mësimore	Datat	Temat mujore	Temat javore
Shtator	1	09–13 shtator 2024	Sa i bukur kopshti im	Kopshti im
	2	16–20 shtator 2024		Shokët/shoqet dhe mësuesja ime
	3	23–27 shtator 2024		Në kopsht luajmë dhe mësojmë
Tetor	4	30 – 4 tetor 2024	Në kopësht vij me dëshirë	Sa i bukur kopshti im
	5	7 – 11 tetor 2024		Ngjyrat e vjeshtës
	6	14 – 18 tetor 2024	Vjeshtë e artë	Vjeshta është bujare
	7	21 – 25 tetor 2024		Cili jam unë?!
	8	28–31 (1) tetor 2024		Trupi im
Nëntor	9	4– 8 nëntor 2024	Kujdesi për shëndetin	Kujdesi për shëndetin tim
	10	11 – 15 nëntor 2024	Festat e Nëntorit	Unë kam të drejtë...
	11	18–21 nëntor 2024		Dita e Alfabetit
	12	25–27 nëntor 2024		Festat e Nëntorit
Dhjetor	13	2 - 6 dhjetor 2024	Toka dhe festat	Dita dhe nata
	14	10–13 dhjetor 2024		Po afrohen festat
	15	16–20 dhjetor 2024		Përgatitja për festë
	16	23–27 dhjetor 2024		Festojmë së bashku
	17	30-31 dhjetor 2024		Traditat e festës së Vitit të Ri

SHTATORI

TEMA MUJORE: SA I BUKUR KOPSHTI IM

Rezultatet specifike të të nxënit për të cilat do të vëzhgohen fëmijët dhe do të vlerësohen arritjet e tyre					
Gjuhë shqipe	Matematikë	Dituri natyre	Edukim për shoqërinë	Arte (Muzikë&Art pamor)	Edukim fizik, sporte dhe shëndet
<p>1.Fillon të dëgjojë mësuesin/en dhe shokët kur flasin.</p> <p>2.Thotë emrin dhe jep disa të dhëna për veten.</p> <p>3.Shprehet se çfarë i pëlqen të bëjë në kopsht.</p> <p>4.Flet për lodrat e veta të dashura.</p> <p>5.Përdor fjalët magjike "Të lutem!", "Faleminderit".</p> <p>6.Ritregon përrallën (me ndihmën e të rriturit).</p> <p>7.Jep përgjigje të thjeshta.</p> <p>8. Dallon emrin e vet në etiketat që shikon.</p>	<p>1.Tregon deri në sa di të numërojë.</p> <p>2.Dallon çfarë ka më shumë në klasë: vajza apo djem.</p> <p>3.Fillon të orientohet në plotësimin e kalendarit me datën dhe muajin.</p> <p>4.Fillon të përdorë fjalët që tregojnë kohë: mëngjes, drekë, darkë.</p>	<p>1.Emërton ditët e javës.</p> <p>2.Tregon nevojat bazë dhe i/e kryen i pavarur.</p>	<p>1.Përhëndet sipas rastit "Mirëmëngjesi!" dhe "Mirupafshim!".</p> <p>2.I përgjigjet përshëndetjeve që i bëhen.</p> <p>3.Vë re tipare të përbashkëta dhe ndryshime me fëmijët e tjerë.</p> <p>4.Zgjedh veprimtarinë që i pëlqen në qendrat e aktivitetit..</p>	<p>1.Vizaton duke përdorur mjete dhe materiale të ndryshme.</p> <p>2.Tregon për këngën që pëlqen.</p> <p>Vizaton vija të drejta.</p>	<p>1.Zbaton praktikat higjieno - sanitare.</p> <p>2.Mëson të qëndrojë gjatë një veprimtarie ditore.</p> <p>3.Merr pjesë në lojërat që zhvillohen në grup.</p>

JAVA 1

TEMA: "KOPSHTI IM!"

Dita	Data	Tema ditore	Temat për çdo fushë të nxëni					
			Gjuhë shqipe	Matematikë	Dituri natyre	Edukim për shoqërinë	Arte	Edukim fizik, sporte dhe shëndet
E hënë	9	Kopshti ynë	Kopshti im				Kënga që më pëlqen të dëgjoj/këndoj	
E martë	10	Pak histori për kopshtin tonë	Vjersha "Kopshti im"	Di të numëroj deri në _____		Emocionet dhe ndjenjat e para në kopsht		Higjiena personale
E mërkurë	11	Njerëzit që shohim në kopsht	Mësuesja ime/drejtoresha e kopshtit Sanitarja Roja i kopshtit		Jemi rritur gati për në kopsht			
E enjte	12	Mjediset e kopshtit	Nga njëri mjedis në tjetrin	Numëroj shkronjat e emrit tim			Ngjyra që më pëlqen	
E premte	13	Grupi im	Emri i grupit tim			Koncepti për grupin		Unë di të luaj lojën...

JAVA 2

TEMA “SHOKËT/SHOQET DHE MËSUESJA IME”

Dita	Data	Tema ditore	Temat për çdo fushë të nxëni					
			Gjuhë shqipe	Matematikë	Dituri natyre	Edukim për shoqërinë	Arte	Edukim fizik, sporte dhe shëndet
E hënë	16	Nga shtëpia në kopsht	Kush më sjell në kopsht?;	Numëroj shokët e tavolinës			Kënga që më pëlqen të dëgjoj/këndoj	
E martë	17	Mëngjesi im	Veprimet rutinë		Unë jam djalë			Gjymnastika e mëngjesit
E mërkurë	18	Fjalët përshëndetëse	Mirëmëngjesi! Mirëdita! Mirupafshim!		Unë jam vajzë	Si të përshëndesim kur vijmë në kopsht		
E enjte	19	Miqësitë e para	Shoku im i parë/ shoqja ime e parë	Më shumë _____ më pak _____ (vajza/djem)		Si të përshëndesim kur largohemi nga kopshti		Lojëra në oborr
E premte	20	Rregullat në kopsht	Rregullat që lidhen me të dëgjuarin dhe të folurin				Pema me mësuesen, shokët dhe shoqet e grupit	

JAVA 3

TEMA “NË KOPSHT LUAJMË DHE MËSOJMË”

Dita	Data	Tema ditore	Temat për çdo fushë të nxëni					
			Gjuhë shqipe	Matematikë	Dituri natyre	Edukim për shoqërinë	Arte	Edukim fizik, sporte dhe shëndet
E hënë	23	Në kopsht vijmë pa qarë	Përralla “Ç’i ndodhi një ditë arushit të vogël!” Libri: “Përralla me një mësim dhe vizatim-1”, faqe 5-10	Përdorimi i kalendarit data dhe muaji		Ngjashmëritë dhe ndryshimet me të tjerët		
E martë	24	Rregullat e mirësjelljes	Fjalët përshëndetëse	Numëroj deri në 3 duke shoqëruar njëpërnjë	Ditët e javës		Llojet e vijave	Larja e duarve pas loje, para ushqimit
E mërkurë	25	Në kopsht luajmë dhe mësojmë	Qendrat dhe veprimtaritë në to	Fjalët që tregojnë kohë: mëngjes, drekë, darkë		Veprimet rutinë në kopsht		
E enjte	26	Kujdesi për lodrat e kopshtit	A mund të marr në kopsht një lodër/ kukull?		Në kopsht vij 5 ditë; 2 ditë i kam pushim			
E premte	27	Në kopsht vijmë të pastër e të rregullt	Çanta e kopshtit dhe mjetet e saj	Numëroj deri në 5			Kënga “O maçok, çamarrok”	Loja lëvizore “Roza rozina”

- ✓ **Produkti për të cilin do të punohet gjatë muajit**
 - Album me fotografi të fëmijëve të grupit;
 - Kolazh me punimet e para të fëmijëve;
 - Kolazh me gjëra të mbledhura nga pushimet verore

- ✓ **Burimet, materialet dhe mjetet didaktike.**

Për mësuesen:

- Materiale mbështetëse për zhvillimin gjuhësor – Grupi i parë
- Metodika sipas fushave të zhvillimit, “Polis”, 2012
- Ditë pas dite – Grupi i parë
- Fletorja e ditarit

Për fëmijët:

- Libri 1 - Gjuhë shqipe; Muzikë; Arte pamore; Edukim për shoqërinë – Grupi i parë
- Libri 2 – Matematikë; Dituri natyre; Edukim fizik, sportet dhe shëndeti – Grupi i parë
- Mësime dhe lojëra inteligjente – Grupi i parë
- Teste për mua – Grupi i parë
- Veprimtari praktike sipas fushave të zhvillimit - Grupi i parë
- Mëso, luaj, argëtohu – Grupi i parë
- Kartelat didaktike të gjuhës shqipe, grupi i parë: “Luajmë duke mësuar alfabetin”
- Kartelat didaktike të matematikës “Luajmë duke mësuar numrat, ngjyrat dhe format”, Grupi i parë

Përralla e muajit: Libri: “Përralla me një mësim dhe vizatim”, faqe 5-10

Muaji: Tetor

Tema: Në kopësht vij me dëshirë & Vjeshtë e artë

Rezultatet specifike të të nxënit për të cilat do të vëzhgohen fëmijët dhe do të vlerësohen arritjet e tyre					
Gjuhë shqipe	Matematikë	Dituri natyre	Edukim për shoqërinë	Arte (Muzikë&Art pamor)	Edukim fizik, sporte dhe shëndet
1.Bën pyetje të thjeshta. 2.Merr pjesë në biseda. 3.Komunikon me moshatarët. 4. Flet me dëshirë. 5. Dëgjon një histori apo përrallë nga fillimi në fund.	1.Njih numërorin 0 2.Numëron deri në 3. 3. Lexon numërorët të paktën deri në 1.	1.Vëzhgon motin dhe karakteristikat e thjeshta të tij. 2.Shfaq kuriozitet të mësojë diçka të re. 3.Njih stinët dhe karakteristikat e thjeshta të tyre. 4. Vëzhgon objektet.	1.Ka besim te vetja. 2.Rrit pavarësinë gjatë kryerjes së veprimeve. 3. Tregon kujdes për veten. 4. Ka respekt për veten dhe shokët. 5. Shfaq interes për njerëzit që e rrethojnë.	1.Dallon tingujt muzikorë nga zhurmat. 2.Bashkon tre ose më tepër pjesë të një lodre. 3. Dëgjo muzikë.	1.Lëviz lirshëm me kënaqësi dhe vetëbesim gjatë lojërave në mjedisin ku jeton. 2.Njih rregullat e të ngrënit dhe të fjeturit. 3. Kryen lloje të ndryshme veprimesh (kërcim, rrëshqitje, rrotullim etj). 4. Mëson praktikat higjieno-sanitare.

Dita	Data	Tema ditore	Temat për çdo fushë të nxëni/Lëndët					
			Gjuhë shqipe	Matematikë	Dituri natyre	Edukim për shoqërinë	Arte	Edukim fizik, sporte dhe shëndet
E hënë	30.09	Më pëlqen grupi im	Bisedë – Të pëlqen grupi? Pse?		Rregullat e grupit		Kënga “Porsa ngrihem në mëngjes”	
E martë	1	Kopshti ka rregulla	Një ditë dëgjova për Kësulëkuqen që nuk i zbatoi rregullat Libri 1 – Gjuhë, faqe 5	Numri natyror 0		Sendet dhe shenja vetjake		Lojë: Ecje sipas vijave
E mërkurë	2	Unë kujdesem për veten	Bisedë – Çfarë të pëlqen të veshësh?	Me këtë formë ngjan....			Ngjyros me ngjyrat që dua Libri 1 – Arte, faqe 30	
E enjte	3	Kopshti ka shumë lodra	Vjersha “Kopshti im”	Gjej sa janë...	Emërto e përshkruaj lodrat e grupit që tregojnë kafshë shtëpiake		Punë me plastelinë – Kafsha që dua më shumë	
E premte	4	Lojë	Lojë me role: “Në shtëpi”	Zeroja është një numër i veçantë Libri 2 – Matematikë, faqe 5		Ndajmë lodrat së bashku		Loja “Hapa-dollapa”

Java II

Tema javore: Ngjyrat e vjeshtës

Dita	Data	Tema ditore	Temat për çdo fushë të nxëni/Lëndët					
			Gjuhë shqipe	Matematikë	Dituri natyre	Edukim për shoqërinë	Arte	Edukim fizik, sporte dhe shëndet
E hënë	7	Stina e vjeshtës (karakteristikat)	Bisedë – Si është moti sot?		Simbolet e motit		Vizatoj atë që ndiej Libri 1 – Arte, faqe 40	
E martë	8	Pemët në vjeshtë	Përshkrim dhe imitim zhurmash të gjetheve kur bien, kur shkelen, kur fëshfërijnë etj.	Kuptimi i numrit natyror – Numëro 1 Libri 2, Matematikë – faqe 7		Me shokët sillemi siç duhet		Lojë: Të kapa
E mërkurë	9	Gjethet e pemëve (madhësia, forma, ngjyra) I madh, i vogël	Emërto figurat – Libri 1–Gjuhë shqipe, faqe 7	Koncepti i madh/ i vogël			Përshkrim dhe punë me plastelinë	
E enjte	10	Kolazh me gjethe	Përshkruaj gjethet që ke sjellë në grup për kolazhin me gjethe	Shkruaj 1, numëro 1 Libri 2 – Matematika, faqe 8	Kolazh me gjethe		Kënga “Porsa ngrihem në mëngjes”	
E premte	11	Pemët në vjeshtë	E verdhë jam dhe lëkurë kam? Kush jam? – Gjëegjëza për mollët	Bashkësi me mollë të kuqe dhe mollë të gjelbra		Kujdesemi për pemët		Lojë:imitim i vjeljes së mollëve

Java III

Tema javore: Vjeshta është bujare

Dita	Data	Tema ditore	Temat për çdo fushë të nxëni/Lëndët					
			Gjuhë shqipe	Matematikë	Dituri natyre	Edukim për shoqërinë	Arte	Edukim fizik, sporte dhe shëndet
E hënë	14	Vjeshtë bujare, vjeshtë e artë!	Vjershë – Vjeshtë e artë.		Bimë dhe kafshë Libri 2 – Dituri natyre, faqe 46		Kënga “Porsa ngrihem në mëngjes”	
E martë	15	Njohim frutat e stinës	Emërtojmë frutat e stinës së vjeshtës	Shkruaj 1, numëro 1 Libri 2 – Matematika, faqe 8		Trupi im Libri 1 – Edukim për shoqërinë, faqe 47		Lojë: Ecje sipas vijave
E mërkurë	16	Frutat kanë vitamina	Tregoni një histori për frutat që ju pëlqejnë me shumë	Kuptimi numrit natyror “2” Libri 2 – Matematika, faqe 9			Lepurushëve iu pëlqejnë karrotat Libri 1 – Arte, faqe 32	
E enjte	17	Sallata me fruta	Çfarë ndodh më pas? Libri 1 – Gjuhë shqipe, faqe 8	Duhet teme	Sallata me fruta na bën mirë për shëndetin. Punë në grupe.		Aplikacion me fruta	
E premte	18	Ikën dallëndyshet	Vjersha – Dallëndyshe Materiale mbështetëse për zhvillimin gjuhësor –Grupi i parë	Mëso të shkruash numrin 2 Libri 2 – Matematika, faqe 10		Ndajmë lodrat së bashku		Loja “Hapa-dollapa”

Java IV

Tema e javës: Cili jam unë

Dita	Data	Tema ditore	Temat për çdo fushë të nxëni/Lëndët					
			Gjuhë shqipe	Matematikë	Dituri natyre	Edukim për shoqërinë	Arte	Edukim fizik, sporte dhe shëndet
E hënë	21	Çfarë ndodh më pas?	Rrëfime ngjarjesh Libri 1 -Gjuhë, faqe 21		Më parë-tani-më pas. Përshkrim i një fenomeni		Ngjyrosje e farës dhe lules	
E martë	22	Kuptimi numrit natyror "3"	Bisedë: 3 gjëra që ju pëlqejnë	Numëro deri në 2 Numëro deri në 3 Libri 2 – Matematikë faqe 10-11		Mësojmë 3 nga rregullat e grupit		Ecje duke numëruar deri në 3
E mërkurë	23	Vjershë "Numri 3"	Materiale mbështetëse, Grupi 1, faqe 29	Mëso të shkruash numrin 3 Libri 2 – Matematikë faqe 11			Aplikacion numri 3	
E enjte	24	Shqisat te njeriu (Gjuha-shqisa e të shijuarit...)	Bisedë: Çfarë më shijon më shumë? Gjëza për gjuhën	Numëro 3, shkruaj 3 Libri 2 – Matematikë faqe 12	Gjuha-shqisa e të shijuarit...) Libri 2 – Dituri natyre, faqe 47		Punë më plastelinë	
E premte	25	Përralla "Ç'i ndodhi një ditë arushit të vogël"	Personazhet dhe mësimi që nxjerrim nga përralla.	Vizato deri në 3 Libri 2 – Matematikë		Të dëgjojmë më të rriturit		Lojë: Prite topin

			Libri: "Përralla me një mësim dhe vizatim-1", faqe 5-10	faqe 13				
--	--	--	--	----------------	--	--	--	--

Java V

Tema javore: Trupi im

Dita	Data	Tema ditore	Temat për çdo fushë të nxëni/Lëndët					
			Gjuhë shqipe	Matematikë	Dituri natyre	Edukim për shoqërinë	Arte	Edukim fizik, sporte dhe shëndet
E hënë	28	Shqisat te njeriu (Duart-shqisa e të prekurit...)	Bisedë – Duart e mia		Duart-shqisa e të prekurit... Libri 2 – Dituri natyre, faqe 47		Vizatim i dorës së fëmijëve me shabllon	
E martë	29	Higjiena vetjake (Të jesh i shëndetshëm...)	Lepurushët - higjienushët CD-grupi i parë-Polis	Shuma 3 Libri 2 – Matematikë faqe 15		Rregullat e higjienës		Të jesh i shëndetshëm Libri 2 - Edukim fizik, faqe 63
E mërkurë	30	Kuptimi numrit natyror - 4	Pula bardhoshe– Libri: "Përralla me një mësim dhe vizatim-1", faqe 11-16	Numëro deri në 4 Libri 2 - Matematika, faqe 16			Ngjyros me ngjyrat që dua	
E enjte	31	Të jemi të pastër	Vjershë "Pastërtisë" Materiale mbështetëse, Grupi 1, faqe 44	Numërojmë sendet që na duhen për të mbajtur pastër trupin	Emërto e përshkruaj sendet që na shërbejnë		Përsëritje e Këngës: "Porsa ngrihem në mëngjes"	

					për të mbajtur pastër trupin			
E premte	1.11	Trupi dhe lojërat fizike	Rëndësia e ushtrimeve për trupin e njeriut – Bisedë dhe ilustrim	Thuaj emrat e 4 shokëve apo shoqeve		Mësojmë të lajmë dhëmbët		Loja “Dhelpira” Materiale mbështetëse, Grupi 1, faqe 126

✓ **Produkti për të cilin do të punohet gjatë muajit**

- Kolazh me gjetet e vjeshtës, të formave e ngjyrave të ndryshme.
- Poster me figura që tregojnë rregullat e grupit.

✓ **Burimet, materialet dhe mjetet didaktike.**

Për mësuesen:

- Materiale mbështetëse për zhvillimin gjuhësor – Grupi i parë
- Metodika sipas fushave të zhvillimit, “Polis”, 2012
- Ditë pas dite – Grupi i parë
- Fletorja e ditarit

Për fëmijët:

- Libri 1 - Gjuhë shqipe; Muzikë; Arte pamore; Edukim për shoqërinë – Grupi i parë
- Libri 2 – Matematikë; Dituri natyre; Edukim fizik, sportet dhe shëndeti – Grupi i parë
- Mësime dhe lojëra inteligjente – Grupi i parë
- Teste për mua – Grupi i parë
- Veprimtari praktike sipas fushave të zhvillimit - Grupi i parë
- Mëso, luaj, argëtohu – Grupi i parë
- Kartelat didaktike të gjuhës shqipe, grupi i parë: “Luajmë duke mësuar alfabetin”
- Kartelat didaktike të matematikës “Luajmë duke mësuar numrat, ngjyrat dhe format”, Grupi i parë
- “Përralla me një mësim dhe vizatim-1”

✓ **Përralla e muajit: “Kësulëkuqja” dhe “Pula bardhoshe”**

✓ **Vjersha: Vjeshtë e artë**

✓ **Gjëza: Dallëndyshe**

Muaji: Nëntor

Tema: Kujdesi për shëndetin/Festat e Nëntorit

Rezultatet specifike të të nxënit për të cilat do të vëzhgohen fëmijët dhe do të vlerësohen arritjet e tyre					
Gjuhë shqipe	Matematikë	Dituri natyre	Edukim për shoqërinë	Arte (Muzikë&Art pamor)	Edukim fizik, sporte dhe shëndet
